



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-12957 /2025

Datë: 30.09 /2025

Duke u mbështetur në shkronjën n) dhe r) të nenit 17, nenin 40. paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës nr.03/L-040, Ligjin Për Financat Publike dhe Përgjegjësitë nr.05/L-007 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-048, Nenit 2 dhe 3 të Ligjit Nr.03.L-049, nenit 7 dhe 8 të Rregullores për Subvencione dhe Transfere /2015, nenin 40 pikën 3) të Statutit të Komunës, me kërkesën nr .prot. 01-644-8473/25 të datës 26.03.2025 e parashtruar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, si dhe me Rekomandimet e KPF-së të datës:07.04.2025, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IV-të të rregullt për vitin 2025, të mbajtur me datën: 25.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Për

ndarjen e mjeteve buxhetore për mbajtjen e festivalit folklorik “ I Këndojmë Lirisë”

1. Miratohet kërkesa e DKRS-së për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 30,000.00 euro (Tridhjetë mijë) euro, për organizimin dhe mbajtjen e festivalit folklorik “I Këndojmë Lirisë.”
2. Vendimi si në nenin 1 të këtij Vendimi miratohet me kërkesën e parashtruar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport me nr. prot. 01-644-8473/25 të datës 26.03.2025.
3. Mjetet ndahen nga kategoria e subvencioneve në DKRS, Programi (850), Nën programi (85018) Kodi funksional (0820) ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi obligohen drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim.
4. Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunës;
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.



**Kryesuesi i Kuvendit
Fadil Gashi**